



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 40, datë 10.12.2025

PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR VITIN 2026

Në bazë dhe në zbatim të nenit 44, pika 1, shkronja “a”, të nenit 52, pika 1, shkronja “gj” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 1, shkronja “b” të Rregullores “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendim qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 34, datë 27.11.2020, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, si dhe të nenit 18 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2026, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autorizohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm për dërgimin në Autoritet Mbikëqyrës të njoftimit për miratimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2026, si dhe një kopje të tij.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.





4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

